

INTERVISTË ME BAHTIJE ABRASHIN

Prishtinë | Data: 14 shkurt, 2022

Kohëzgjatja: 122 minuta

Të pranishëm:

- Bahtije Abrashi (E intervistuar)
- Anita Susuri (Intervistuesja)
- Renea Begolli (Kamerë)

Simbolet e komenteve në transkriptë të komunikimi jo-verbal:

() - komunikim emocional

{ } - i intervistuari shpjegon me gjeste

Simbole të tjera në transkriptë:

[] - shtesë e tekstit për të lehtësuar kuptimin

Fusnotat janë shtesa editoriale që japin informacion mbi vendbanime, emra apo shprehje.

Pjesa e Parë

Anita Susuri: Zonja Bahtije, nëse mundeni me u prezantu? Me na tregu diçka për vetën? Familjen e ju?

Bahtije Abrashi: Unë prezentohem, po ndoshta po falenderohem që keni gjetë kohë, që ju ka ra në mend, se unë tash jam në moshën e tretë. Mbetet një dokument. Faleminderit shumë.

Anita Susuri: Faleminderit juve.

Bahtije Abrashi: Po. Unë jom lindë në Mitrovicë në vitin, 10 janar 1944. Jom rritë në një familje, baba im s'pari ka qenë minator i Trepçës, mandej ka qenë pjesëmarrës në Luftën Nacional Çlirimtare, domethanë në Luftën e Dytë Botërore. Ka qenë i plagosur. I ka meritat e luftës edhe një shkallë ma tutje kishte me qenë hero i popullit, bartës i përkujtimeve të '41-shit. Ndoshta ju rinia s'i... pak jeni të informuar, por që u dha rasti. Ai... gjashtë fëmi kena qenë, na ka eduku nana edhe baba në ni frymë, ndoshta revolucionare. Unë si e re e kom kry shkollën tetëvjeçare, shkollën e mesme... shkollën tetëvjeçare, thashë në Mitrovicë. Mandej jam regjistru në gjimnaz të Mitrovicës. Mas ni muji a dy është hapë Shkolla Normale pranë gjimnazit të Mitrovicës.

Erdhi baba im i ndjerë edhe më thotë, "O çika jeme, ish hapë në Mitrovicë shkolla e msusisë", nuk tha Shkolla Normale. Po ashtu e ka... në sytë e tij më len me kuptu që ai kishte shumë qejf t'shkoj une te kry Shkollën Normale dhe të bëhem msuse. Se ka qenë i etshëm për shkollë, se ai s'ka qenë në shkollë po ka qenë autodidakt. Vet ka mësu me shkru e me lexu. Njëashtu edhe nana. Edhe po i them, "Duhna me u nënshtru edhe niherë provimit pranus", "Hajt, hajt se e jep". Edhe ka bisedu me drejtorin, iu nënshtrova provimit pranues edhe u regjistrova në... kalova në klasë të Shkollës Normale. Unë dhe shoqet e mija, disa ende janë, disa nuk janë, kemi kry Shkollën Normale në Mitrovicë, gjenerata e parë e Mitrovicës.

Mirëpo si, në atë kohë kam qenë edhe aktiviste e rinisë, qashtu kam qenë e edukume. Kam marrë pjesë edhe në shumë aktivitete sportive, kam qenë besa notuese. Se Mitrovica ka qenë ni qytet si me e thanë, internacional, të gjithë kena qenë aktiv. '63-shin kam zënë vendin e tretë në Serbi në not. Ndofta osht' intersant, por masi më pytët për jetë. Po. '64-shin shumë shpejtë, herët jam martu. Mas martesës kam kalu bashkë me bashkëshortin, Aziz Abrashin, në Prishtinë. Ai e ka kry fakultetin në

Beograd. Ka qenë kuadër defiçitar për Kosovën edhe e kanë tërënjëqëq menihere në Prishtinë. Mirëpo edhe une me të.

Fati unë jam punësu në shkollën “Emin Duraku” në Prishtinë. Ai është, ka kalu në Odën Ekonomike të Kosovës. Kena fillu aty jetën. Unë kam vazhdu Akademinë Pedagogjike në Prishtinë. Pastaj kanë qenë do provime shtetnore pak ma, si me thanë, ma kujdes i madh ka qenë ndaj profesionit të mësuesit për me qenë ma i aftë për me i eduku gjeneratat e reja. Mandej, si çdo nanë, si çdo grua kam lindë dy fëmijë vajzën, djalin. Kështu që, bashkë me ta jom rritë. Janë rritë, kanë qenë t’suksesshëm, nxanësa të suksesshëm. Mandej...

Anita Susuri: Kisha dashtë me u kthy pak mbrapa se përmende disa detaje që po më interesojnë ma shumë, t’u fillu prej babës t’juj që ka qenë ushtar në Luftën e Dytë Botërore. A dini ndonjë tregim ma shumë diçka lidhur me ato betejat që kanë ndodhë? Ose ku ka marrë ai pjesë, në çfarë brigade?

Bahtije Abrashi: Ai ka qenë në Brigadën Shala e Bajgorës. U plagosë tri herë. Disa herë janë mundu me e zanë të gjallë, mirëpo nuk kanë mujtë. Ia kanë marrë nanën në burg, ia kanë kallë shtëpinë, ia kanë marrë motrën në burg, në burgun famkeq pranë Mitrovicës, Shipol. Mirëpo, nuk e di qysh ka mujtë... ka pasë njerëz edhe aty që i kanë ndihmu edhe i kanë liru pas ni kohe, nuk e di sa kohë prej burgut. E kanë... me vajzën. Vajza e cila ka pasë emrin Vahide, une nuk e mbaj mend se... si ka ardhë prej burgut, “Kurrë”, thoshte nana ime, “s’ju kanë tërë sytë veç t’u qajtë”. Me atë ankth, me atë mërzi edhe ka vdekë. Kështu që, kur s’kanë mujtë ata me zanë armiku, ia ka shkatërru familjen. Kështu që, nuk e ka pasë lehtë.

Mas luftës ka qenë shumë aktiv në Mitrovicë, ka qenë njeri i çmuar, i respektuar, ka qenë edhe kryetar i Mitrovicës ni kohë të shkurtë, derisa kanë gjetë njeri të arsimuar. Por, ai e ka kry punën e vet.

Anita Susuri: Si është kujtë baba ju?

Bahtije Abrashi: Baba im quhet Qazim Bajgora. Ai e ka pasë emrin, mbiemrin Mehmetović, përpara me “viç”. Edhe kurqysh s’e ka pranu atë mbiemrin “viç” edhe meniherë e ka kthy mbiemrin Bajgora. Se edhe fshati i tij ka qenë Bajgora. Kështu që, ka qenë një njeri revolucionar. Na ishim gjashtë fëmijë, dy vajza, katër djem. Të gjithëve na ka shkollu. Atëherë jipshin bursa fëmive të luftëtarëve për me u shkollu. Edhe atëherë ka pasë pengesa, nuk i kanë dhanë. Asni fëmi s’ka marrë bursë prej shtetit. Kanë pasë rezerva edhe ndaj tij. Ka kry vllau i madh në Beograd fakultetin, i dytë inxhinier në Mitrovicë, i treti ka pasë qef me qenë rrobaqepës, ai, une msuse, motra tjetër ka kry gjimnazin, ka qenë përkthyesë në ente, një përkthyesë shumë e aftë edhe vllau i vogël edhe ai inxhinier. Kështu që, të gjithëve na ka arsimu, na ka shkollu.

Anita Susuri: Thatë që baba ju ka punu edhe n’minierë...

Bahtije Abrashi: Po, minator...

Anita Susuri: Cila periudhë ka qenë? A ka qenë para luftës...

Bahtije Abrashi: Para Luftës të Dytë Botnore. Ai ka qenë minator, prej minatorit ka kalu në Luftën Nacional Çlirimtare.

Anita Susuri: A ju kujtohet ndoshta ndonjë tregim se qysh ka qenë atëherë miniera? Me punu n'minierë? Me siguri ka qenë shumë vështirë.

Bahtije Abrashi: Shumë pak kanë ndryshu kushtet. N'atë kohë kanë udhëheq angleztë, ka qenë edhe greva e minatorëve kundër anglezëve se e kanë shfrytëzu, ai ka qenë edhe pjesëmarrës aty. Kështu që, qysh i ri ka qenë aktivist revolucionar.

Anita Susuri: A dini ma shumë diçka për qat' grevën me na tregu?

Bahtije Abrashi: Për atë grevë, e thashë, kanë qenë kundër shfrytëzimit të Anglisë Minierën e Trepçës. Po. Çdo herë e kanë shfrytëzu. Mandej e ka shfrytëzu Jugosllavia, po Jugosllavia në kuptimin ma të lartë ma pak, Serbia e ka shfrytëzu shumë. Përpara kur janë kthi qata anglezë që kanë punu në fillim, ka ardhë dikush i moshuar, e ka tërheqë Mitrovica, ka thanë, "Na kena mendu që edhe trotuarin e keni të arit, e qysh kështu?" Kështu që, qaq shumë e kanë shfrytëzu saqë s'na kanë lanë kurgjo.

Anita Susuri: Deshta me ju pytë për pjesën e fëmijërisë se ju jeni fëmijë që keni lindë në Luftë të Dytë Botnore, '44-shin, si fmi si e kujtoni Mitrovicën? Qysh ka qenë? Mas luftës...

Bahtije Abrashi: Do ta them me ni, noshta le t'jetë dokumentar. Kur kom lindë gjatë luftës i kanë rrethu. Paska ardhë baba im n'shtëpi me i pa fëmijë që i ka pasë edhe dy djem, unë, nanën, nanën e vet, nanën time, domethanë bashkëshorten e vet. Edhe e kena pasë ni kusheri ka qenë i verbër, po shqisat e të dëgjimit i ka pasë shumë të avancuara. Edhe e ka vrejtë se dikush po e rrethon shtëpinë, ka qenë kojshi, edhe i lajmëron. Ni kohë t'gjatë ai s'kishte qenë në shtëpi se kanë qenë në radhë të partizanëve. E lajmëron babën, thotë, "Po të rrethojnë".

Nana ime edhe baba i lejnë dy djemtë n'shtëpi natën, m'marrin mu se unë e vogël bebe edhe fillojnë me ikë me noj fshat tjetër. Mirëpo, unë kom fillu me qajtë e natën. Në bjeshkë kur qan, ajo, zëri ka jehu. Edhe kta, "O po mbarojmë! Nëpërmes zanit kanë me na gjetë!" Anej knej. Edhe tani kanë ba ni duel, "A e lojmë n'qit zgurrë të lisit, a n'qit zgurrë të lisit?" Mirëpo prindë, s'kanë mujtë me na lanë. Dikur tha nana, "U lodhe u shukate". Kështu që, qajo e lodhnja mu m'ka shpëtu (qeshë). Ka pasë, kanë pasë momente shumë t'vështira t'jetës.

Anita Susuri: A e keni ndrru pastaj si fëmi vendbanimin mas luftës apo kanë vazhdu me jetu?

Bahtije Abrashi: Në Mitrovicë. Jo, jo, në Mitrovicë. Kena ndrru, niherë kena jetu knej Ibrit, n'anën tash po i thojnë jugore mandej kena kalu në anën veriore. Po në anën veriore aty e mbaj në mend fëmijërinë e aktivitetet e shkollimin.

Anita Susuri: Si e kujtoni Mitrovicën? Ka qenë një vend ma ndryshe se qytetet tjera, se ka qenë qytet industrial. Po mendoj, ndoshta ma i zhvillim ka qenë se qytetet tjera.

Bahtije Abrashi: Në krahasim me qytetet tjera ka qenë qytet ma i zhvillim, ma i avansum. Janë zhvillu shumë takime, atëherë të Krahinës Autonome, krejt delegacionet që kanë ardhë kanë ardhë në Mitrovicë. Trepça ka qenë gjigandi i tretë në Ballkan, kështu që ka qenë interesant për të gjithë. Kështu që, në Mitrovicë kush ka ardhë prej qyteteve tjera... mandej n'shkollë të mesme kena pasë kontaktet, po edhe n'shkollë fillore kena pasë kontaktet e pionerëve me qytetet tjera. Kanë thanë, "Oh, po na duket sikur me shku në tjetër shtet. Ktu jeni ma t'avansun, ma".

Rinia ka qenë shumë ma aktive. Besa e kena pasë lbrin ku jena la, jena veshë me kostume t'lamjes me krejt. Për ato, për komunat tjera, për vajzat tjera, për rininë ajo ishte një befasi shumë e madhe. U organizojshin ballot, mbramjet shoqrore. Ka pasë shumë kuadro sportive, takimet sportive, lojnat të ndryshme. Kshtu që ka qenë një qytet shumë i gjallë. Edhe ndërtimi ka qenë pak ma i avansum sidomos në pjesën veriore të Mitrovicës. Tash po hi politikë.

Qysh në atë kohë si te kalojsh urën e lbrit, urën e vjetër, qe ku e kom n'dhomë e fotografoni [u drejtohet intervistuesës], është ndërtu ma shumë. Buzë lbrit ka qenë i thojshin, si fmi e mbaj mend, Mahalla e Boletinëve, Boletin, e Isa Boletinit. Mandej e rrxun krejt mahallën. E më kujtohet kur gratë bojshin muhabet, "Kuku e rrxun krejt Mahallën e Boletinëve. Po dojnë me ndërtu", po e them bukalisht qysh e kanë thanë, "Stan, banesa për shkije". Ato në atë kohë e paskan ditë, nifarë programi t'tyne edhe ashtu u bo.

Anita Susuri: Domethanë, ka fillu me ndryshu infrastruktura e qytet?

Bahtije Abrashi: Infrastruktura n'qytet.

Anita Susuri: E a ju kujtohet ura? A është rrxu po m'doket niherë pastaj u ndërtu urë e re apo?

Bahtije Abrashi: Unë i mbaj në mend tri ura, edhe tash këtë të tretën. Kto që e kam n'muri është ura para luftës, ura e hekrit, ka qenë e fortë ka qenë... e mandej tash ajo urë që osht' e pakalueshme për qytetarë. Histori. Afër urës ka qenë, e kam n'fotografi, xhamia e cila i ka pasë nja 500-600 vjet. E kanë rrxu meniherë gjatë luftës, nuk ekziston më. E kanë betonu krejt oborrin sipërfaqën ku ka qenë xhamia, s'ekziston po vetëm ka mbetë fotografi. Iniciativa ka qenë disa here qët' betonim me hjekë, me rrxu, me pa çka ka poshtë, po nuk lejojnë se po i takon pjesës veriore. Se aty, qysh thojnë qytetarët, ka edhe njerëz që i kanë varrosë e që po i lypin familjet. Atë e kanë dokumentu vet gratë që i kanë pasë shtëpitë, banesën përballë. Është e inçizume, po s'i ka ardhë...

Anita Susuri: Gjatë luftës t'fundit?

Bahtije Abrashi: Gjatë luftës t'fundit. Mirëpo, ndofta s'i ka ardhë ende koha edhe ajo me u çelë e me u pa çka ka poshtë.

Anita Susuri: Desha me ju pytë edhe për kujtimin e nanës t'juj. Thatë që është, ka msu me lexu, me shkru vet si autodidakte...

Bahtije Abrashi: Bashkë me babanë.

Anita Susuri: Çfarë kujtime tjera keni prej nanës? Çfarë grua ka qenë?

Bahtije Abrashi: *Ohh* {onomatope} Ktu po të kapin emocionet po m'kuptoni. Nana ime ka qenë ni gru, gjithkush i lavdon prindtë e vet, po është e vërteta çka e them, që ka rritë gjashtë fëmijë edhe që s'ka ditë me, s'ka mujtë me na ndihmu n'shkollim por ka pasë kujdes, "Shkollonu, msoni. Pse s'po lexoni? A s'keni detyra a?" Ajo para luftës, gjatë luftës, mas luftës është bajtë ferexhja i kanë thanë, të mbuluar, e tash s'di pse po bahet kështu, tash hi në atë temë, me peçe përpara. Krejt ka qenë e mbulume ftyra, kanë pasë veç do si vrima qysh i kanë punu punëdore, vetëm sytë. Mirëpo, ka fillu revolucion mas luftës e krejt. Osh' vendosë që gratë me hek në atë kohë qysh i kanë thanë, ferexhen, edhe unë po i them tash.

Nana ime sikur gru e një luftëtari, një revolucionari, një minatori ka bo presion baba me e hjekë ajo çarçafin, peçen. Mirëpo, është msu qashtu, ka pasë siklet, ka pasë ni revolucion të brendshëm, "Qysh une me e hjekë? Edhe me dalë e para me e hjekë?" Ka shku te baba i vet edhe i ka thanë, "O babë, kom presion" qishtu, qishtu, "Prej", të ndjerit babës tem, "Qazimit, me hjekë". Ai ka mendu edhe i ka thanë, "Pse jo çika jeme? N'qoftëse osht' marre është për të, nëse është sevap është për të. Duhesh me hjekë". Shumë sene i ndryshum mbas luftës.

Edhe në ni tubim t'madh, e kam fotografinë, e kam artikullin në Zërin e Rinisë, ajo e hek ferexhen edhe e gjun naltë, thotë, "E pash dritën" (qan). Osh' në revistën Kosovarja, gazetarja Nafije Latifi e ka rrëfimin e saj direkt. E ajo e ka edhe fotografinë kur e ka... dikush e ka fotografu kur e ka hudh ferexhen naltë edhe thotë, "E pash dritën".

Anita Susuri: Prej asaj kohe pastaj kanë fillu edhe gratë tjera, apo?

Bahtije Abrashi: Po mandej normal gratë tjera. Si duket mas ktyre pjesëmarrësve të Luftës Nacional Çlimitare njerëzit kanë fillu me u shkollu. Po n'atë kohë, çika jeme 95 përqind kanë qenë kosovartë njerëz analfabetë. E thashë që autodidakt ka qenë edhe nana edhe baba.

Anita Susuri: I përmendët disa ngjarje kulturore edhe sportive që kanë ndodhë në atë kohë edhe e përmende që ke qenë notare.

Bahtije Abrashi: Po.

Anita Susuri: Po, a ka qenë ky angazhim prej shkollës diçka apo ka qenë klub i veçantë?

Bahtije Abrashi: Klub i veçantë ka qenë n'nivel të Mitrovicës. Ka qenë trajneri ni burrë, ani që ka qenë serb, Slavko Çebasak. Ma s'pari ka qenë pishina në Trepçe, tani në Stantërg ku e kanë ndërtu angleztë.

Aty kena ushtru, aty kena zhvillu trajnimet. Pastaj u ndërtu në Mitrovicë në Zveçan pak ma moderne, pak ma mirë. Mandej aty. Mandej kena bo gara. Qytetet s'ka pasë në asi... kena fillu me bo gara me Republikën e Serbisë për republika tjera. Po kisha bo [gara] edhe për republika tjera, po u martova herët (qeshë).

Anita Susuri: E në Stantërg është shumë interesant se tash nuk ekzistojnë ato, janë shkatërru.

Bahtije Abrashi: Janë shkatërru.

Anita Susuri: Po m'intereson qysh u dukë ajo. A ka pasë edhe zhveshtore?

Bahtije Abrashi: Krejt.

Anita Susuri: A ka pasë disa bazene?

Bahtije Abrashi: Me zhveshtore, ni bazen ka qenë dhe ka qenë bazen olimpik.

Anita Susuri: Edhe zhveshtore.

Bahtije Abrashi: Me zhveshtore, me fusha me me krejt i kanë ndërtu angleztë.

Anita Susuri: Deri n'cilin vit keni ushtru ju aty?

Bahtije Abrashi: Une kom ushtru aty prej '62-shit, '63-shit kom qenë n'gara. Krejt vitin '62 kom qenë ushtruese e notit.

Anita Susuri: E qysh kanë qenë kto udhëtime që i keni bo?

Bahtije Abrashi: Not shkojshin në Stantërg ni autobus të minatorëve. Se minatorët kanë pasë autobus, po mandej kanë bashkëpunu sigurisht trajneri me ta dhe n'ora kaq u takojshim në Mitrovicë edhe shkojshim. Kena qenë, ma tepër ka pasë serbe, ma pak ka qenë numri i vajzave shqiptare e qishtuqe.

Anita Susuri: A ka ekzistuar ndoshta atëherë paragjykimi për vajzat që janë shkollu ose që...

Bahtije Abrashi: Një paragjykim shumë i madh.

Anita Susuri: Si jeni ndierë ju për shembull, a ka qenë qajo ku ka stopu...

Bahtije Abrashi: Unë jam ndi mirë se babën e kom pasë, thashë, t'etshëm për shkollë. Ka qenë i etshëm me u emancipu grua shqiptare. Thashë 95 përqind kanë qenë analfabetë. Kështu që, është ba luftë e madhe. Unë, tash po e thrras, prapë po kthena te une, në klasën e tretë të Shkollës të Mesme të Normales gjatë pushimeve dimrore na kanë caktu me shku... unë kom shku në fshatin Boletin bashkë me t'ndjerën ni kolege, shoqen time t'klasës, Sanijen, e cila ka vdekë. Edhe na kanë thanë, "Keni me i

mbajtë kurset analfabetike”. Kena shku në ni odë të burrave, aty ka qenë masqerga me po... baba im i ndjerë me kali i ka qitë jorgan, çarçafa, jastek krejt na ka pru se s’kishin, ata ishin shumë të varfër. E zoja shpisë flente me neve se na e lshun burrat odën.

Aty i majshim edhe kurset analfabetike. Ka qenë ni grup prej ndoshta 30 nuse edhe vajza. Çdonjana binte ushqim. Flija, pite, pasul, ndofta edhe patate krejt se s’kishim çka me hangër. Suksesi ma i madhi n’jetën time më duket se ka qenë ajo aty. Për 20 ditë ia u kena mësu 36 shkronja t’alfabetit, i kena msu me lexu me rrokje se derisa i binte n’mend shkronja tjetër i thojshim, “Zgjate zanin, qe qitash t’bjen n’mend shkronja”. Kështu që, i mësum me lexu edhe me rrokje.

Ju kena msu numrat deri njëqind, katër veprimet aritmetikore, po kena punu ndoshta edhe ka dhetë orë n’ditë. E ato të etshme vishin. Dimër, me kuaj i bishin. Bora deri ktu {shpjegon me duar}. Mirëpo, kanë qenë t’etshme për me msu me shkru, me lexu. Ka pasë familje që s’i kanë lanë me u shkollu vajzat, sidomos vajzat. Ju kanë dhanë përparësi djemve, jo pse s’kanë dashtë por situata ekonomike ma shumë ju ka diktua me i shkollu djemtë se vajzat. Mirëpo, ka qenë vështirë.

Kena shku shpi për shpi me i bindë me i pru vajzat n’shkollë. Ndoshta nganjëherë ju thojshim, “Kena me iu dënu. Shteti iu dënon n’qoftëse s’i çoni vajzat n’shkollë”. Ka qenë mas luftës ni revolucion shumë i madh për emancipimin e gruas.

Anita Susuri: E çfarë rasti... a ju kujtohet ndonjë rast ndoshta që reagimi ka qenë i keq ose reagimi i mirë i ktyne prindërve për shembull?

Bahtije Abrashi: Po, kanë reagu, “Qysh me shku çika n’shkollë? Kur t’shkon n’shkollë ajo prishet, s’na dëgjon, merr rrugë t’kqija”. Po u dashke në mënyrë diplomatike njerëzore të afërt me i bind se nuk është qashtu.

Pjesa e Dytë

Anita Susuri: Ju m’tregutë që shkollimin pastaj keni vazhdu në Prishtinë?

Bahtije Abrashi: Po.

Anita Susuri: Qysh ka qenë për juve ky transfer me ardhë në Prishtinë? Keni fillu ktu me banu sigurisht?

Bahtije Abrashi: Po. Me thanë që nuk e kam ndi ndryshim shumë t’madh, kam qenë e re jam adaptu shumë shpejt. Me kolektiv ku jam punësu më kanë pritë shumë mirë. Kështu që, e kam gjetë vetën meniherë në Prishtinë.

Anita Susuri: Qysh ka qenë n’atë kohë Prishtina?

Bahtije Abrashi: Ka qenë ni kasaba e vjetër. Qyteti ka qenë i ndërtum deri te semaforat kryesorë. Kur fillun me u ndërtu ndërtesat knej, pjesën tjetër, u çuditshim, shkun n'katun, n'fshat. Kur u ndërtu spitali në Prishtinë, ka qenë ni reagim i madh i qytetarëve të Prishtinës, "Pse na çutë aq larg?" Tash spitali mbeti në qendër të Prishtinës. Kështu që, unë krejt, edhe qit pjesë t'qytetit ku jam tash edhe përreth i maj n'mend krejt ara, shufra. Se ndërtohet kaq shpejtë... e gëzoftë rinia. Zemra po t'bahet mal kur po del n'qytet po e shef.

Anita Susuri: N'cilën lagje keni banu ju?

Bahtije Abrashi: Unë në Prishtinë, kam banu në qendër të qytetit në Prishtinë. E kam pasë meniherë mrapa, atëherë i thojshin Ndërtesa e Komitetit, banesën 15 vjet mandej kom kalu Rugën e Goleshit edhe aty 15 vjet. Domethanë, 30 vjet kom jetu n'qendër. Mandej kom kalu në pjesën e Bregut të Diellit.

Anita Susuri: A keni vizitu atëherë, për shembull, a keni pasë kohë përveç që keni studiu, keni mësu, për evente kulturore. Për shembull, teatro ose kinema?

Bahtije Abrashi: Çdo premierë që ka qenë n'atë kohë edhe ma vonë kena shku. Kom shku sidomos une, bashkëshorti, mandej kur u rriten fmitë edhe fmitë i merrsha, shoqnia. Ka qenë një element kulturor të cilin krejt qytetartë e kena prit me gëzim. Po mbahet premiera, menzi gjeishim bileta. Po, kështu që ky popull shpejt është emancipiu.

Anita Susuri: A ju kujtohet...

Bahtije Abrashi: N'kinema kena shku vazhdimisht.

Anita Susuri: Çfarë filma për shembull? Qysh ka qenë qajo dalje? A është dalë veç për kinema, a është dalë në qytet n'atë rrugën për kinema? Qysh ka qenë?

Bahtije Abrashi: Jo, jo. Në kinema kena shku për me e pa ni film ndoshta kulturor, luftarak. Ka pasë shumë filma indian. Shkojshim, na pëlqente muzika, shkonim. Mirëpo, n'arsim kur kom punu rregullisht niherë n'mujtë i kena çu fmitë n'kinema. E kena zgjedhë filmin, cilin, edukativ për fëmitë. Kështu që, me iu mbjellë kulturën e përcjelljes së filmave.

Anita Susuri: Deri n'cilin vit afërsisht keni bo ksi organizime me shkollë?

Bahtije Abrashi: Po unë n'arsim kom punu deri '79-shin.

Anita Susuri: Domethanë, rregullisht ka pasë...

Bahtije Abrashi: Rregullisht. Në qendër të qytetit ka qenë, për nga ndërtesa e Pioneerëve, ajo aty ku është, ju t'ritë, përballë Televizionit, Radio Televizionit të Prishtinës, ato shitoret që janë përreth t'vogla, mrena ka qenë ndërtesa e Pioneerëve. Aty janë organizu në nivel të komunës aktivitetet për nxansa, për pionerë të llojllojshme. Saqë kanë qenë edhe Shoqata e Ambasadorëve, për me i msu

fmitë shtetet, ambasadortë. Kanë qenë ndofta një nxans që ka qenë ma i zgjutë ma asi, Ambasador i Amerikës, Ambasador i Kinës, i Anglisë, i Francës, Gjermanisë. Edhe mandej u bojke ni debat, dashtë e pa dashtë ata u interesoshin për qat shtet që po e përfaqësojnë.

Kështu që, kemi zhvillu ni kulturë që në të ardhmen duhet me u përgatitë fëmitë, nxansat. M'falni, do t'boj ni krahasim, osht' punu shumë n'arsim n'atë kohë. Me punu n'atë kohë ka qenë krahasim, me punu n'arsim na kanë krahasu arsimtarte e mirë, msustë e mirë baraz me ni minator të Trepçës. Kur e ke kry vitin shkollor, n'fund t'vitit, ndoshta po ju intereson, ke pasë ndonji nxanës t'dobte, nuk ke guxu ti me ia imponu me përsëritë ai apo ajo klasën pa qenë komisioni nivel t'shkollës. Prej arsimtarëve në krye me qenë drejtori.

M'kujtohet n'klasë t'tretë ni detal. E kom pasë ni nxanës, Jakup, s'ja harroj emrin, s'msojke, ka qenë i dobtë, ndoshta i mungojke edhe puna n'shpi edhe n'shkollë. Kishin pasë disa probleme me njerken, baba dy gra e kështu që... edhe vinte inspektori, inspektojke n'orë edhe po m'thotë, "Pse osht' ky fmi i dobtë kta tjetër t'mirë?" Edhe komisioni po thojnë, "Duhet me lanë me përsëritë klasën". Unë kom reagu, "Nxansin tem nuk e la se është jetim me përsërit klasën". Kom punu orë plotësuese me të me ditë t'tana, me mujë, sot është advokat. Rasti që e mora, se ka shumë raste ksi.

Anita Susuri: M'tregutë për kto ngjarjet kulturore po e di që në Prishtinë ka qenë edhe korzoja e t'rive që kanë shëtitë, a keni dalë edhe ju?

Bahtije Abrashi: Çdo, çdo mramje. Ka qenë ni lloj defileje. U veshim, u ndreqshim si vajzat, si gratë, si burrat edhe shëtitshim. Prej, tash po i bjen prej Grandit deri te Kuvendi. U sillshim, u takoshim, t'ritë u pëlqeshin. Po na që ishim t'martum u takoshim, shkojshim në ambëltoen "Korzo". Ambëltoja "Korzo" ka qenë përballë, qysh po i bjen, kur t'shkojsh...

Anita Susuri: Te Kino Armata.

Bahtije Abrashi: Jo, jo. Ma poshtë. Në mbarim të rrugës kryesore, tash është, çfarë kafiqi është aty?

Anita Susuri: "Korneri" është.

Bahtije Abrashi: E aty ka qenë. Ajo ka qenë ambëltoja që jena taku me t'madhe edhe e ka pasë emrin "Korzo".

Anita Susuri: Si jeni njoftu me zotni Aziz?

Bahtije Abrashi: Zotnin Aziz? Uuu {onomatope} m'ktheve shumë mrapa. Unë kam qenë nxanëse e klasës të tretë Normale, ai ka dhanë msim n'shkollën ekonomike. Edhe m'ka pëlqy. Nejse, hajt bre anej bre knej, edhe thotë, "Tregoju n'shpi se po m'pëlqen". Kush guxojke me tregu, nxanëse je shku n'shkollë me u shkollu (qeshë). Në familje ka qenë disiplinë e madhe, "Në ora 8:00 të gjashtit [fëmijët] duhet me kenë në shtëpi". Në qoftëse s'je shku n'mramje në ora 8:00 ke pasë pasoja. Ose s'ke hanger darkë, ose n'qoftëse ka dashtë me t'ble diçka s'ta ka ble, je dënu. Edhe unë po thom, "Jo, jo, unë kom

me shku n'shpi në ora 8:00". Edhe ai bashkë me ni shok të vetin vijnë me mu i bijnë ziles. Unë mbeta, u stepa, edhe hyjnë brenda dhe i tregon babës tim që, "Mu po m'pëlqen vajza jui". Qshtu qishtu.

Anita Susuri: Qysh ka qenë reagimi pastaj?

Bahtije Abrashi: Ka qenë reagim shumë i ashpër n'shtëpi, "Duhesh me u shkollu, me të kam bisedu, nuk bon ajo, duhesh me u shkollu". Na, mirëpo ai bisedoi me të tha, "Shkollimin nuk ia ndali kurrë, ku të don". Se dojsa me shku në Beograd me studiu këtë juridikun, masi i kom dorëzu dokumentet i tërhjeka mbeta në Kosovë dhe u martova.

Anita Susuri: Vendimi jui ka qenë apo rrethanat e kanë bo?

Bahtije Abrashi: Jo, jo. Rrethanat e kanë bo.

Anita Susuri: E qysh ka vazhdu pastaj në vitet '74 e knej? Kanë qenë pak ma t'mira me kushtetuta...

Bahtije Abrashi: Mbasi është aprovu Kushtetuta e Kosovës, '74-shin, Kosova ka lindë për s'dyti, a për s'treti, a për s'gjashti, a t'dhetën a sa. Çdo herë kena qenë të shtypur, s'ju kanë dhanë të drejta kërkujt. Me hi me i qyrë librat, filmat, dokumentartë na thojm, "Qysh kena ekzistu?" Sa dëbimet janë bo, sa shkatërrimet, sa persekutimet, sa vrasjet... e mandej filloi... se kushtetutën e ka propozu Kryesia e Jugosllavisë, e ka hartu. E Kuvendi i Kosovës e ka aprovu.

Me aprovimin e kushtetutës kanë ndrru gjanat për 360 shkallë. U hap fakulteti, u hap universiteti, me t'madhe fillun me u shkollu. Për dhetë vjet nuk e di, i kam pasë shënimet, ni kohë shumë t'shkurtë sa doktori i shkencave ka dalë, e sa profesori, e sa profesoresha, e sa inxhinieri, e sa mjeku, e sa, të gjitha profilet. Se ky popull ka qenë i etshëm për dije. Ka qenë ni program i Serbisë kundër shqiptarëve: "Shqiptarin dëboje, likfidoje, mos e arsimo". Mirëpo, mandej kjo tabu u thy.

Anita Susuri: '79-tën jeni zgjedhë Kryetare e Konferencës Gratë në Prishtinë edhe po m'duket që e keni ndërpre punën n'arsim.

Bahtije Abrashi: Unë si aktiviste e Rinisë¹ kom vazhdu atë aktivitet edhe në Prishtinë. Kom qenë mjaft aktive. Me kalimin tim prej Mitrovicës në Prishtinë, unë kom mendu që do t'shuhen ato. Mirëpo, qashtu kom qenë prej natyrës. Në shkollën ku kom punu kom arritë edhe aty do suksese, saqë ka qenë kolektivi shumë i madh, ndoshta ma e reja kom qenë Kryetare e Bashkësisë Punuese. Mandej, kom qenë delegat në Kuvendin e Prishtinës, edhe aty kom zhvillu aktivitetet nëpër bashkësi lokale sidomos. Sidomos rreth edukimit të fëmijëve dhe emancipimit të gruas. Përpara për me të zgjedhë me ni organ ka qenë Komisioni kadrovik në nivel të komunës, ata ta kanë vlerësu punën edhe kanë vendosë kon ku me çu.

¹ Pas Luftës së Dytë Botërore, SKOJ - *Savez komunističke omladine Jugoslavije* (Lidhja Komuniste e Rinisë Jugosllave) bëhet pjesë e organizatës më të gjerë jugosllave të rinisë, Rinija e Popullit Jugosllav, e cila më vonë u shnëdrrua në Lidhja Socialiste e Rinisë Jugosllave.

Kishin vendosë me m'zgjedhë Kryetare e Konferencës të Grave, ashtu është qytet. Po Kryetare e Grave të Prishtinës, si kryeqytet. Saqë kanë shku me kqyrë në shkollën “Aca Marović²” çfarë fmi, çfarë nxanësa janë. Që duhesh me kenë shembull për rreth, për me t'pranu rrethi edhe me ndiku me punën tande. Po du me tregu, ai Komisioni Kadrovik ka pasë ni rol shumë t'madh. Kom punu, ka qenë referati i konferencës, ka qenë planprogrami, cilat aktivitete kanë me u zhvillu këtë javë, këtë muj, gjysmëvjetor, fund vitit, ke dhanë ni përgjegjësi çka ke punu. Kështu që, kom qenë mjaft aktive. Ndofta e kisha aty çka veç kam punu.

Pastaj kur më kaloi mandati më zgjodhën Kryetare e Konferencës, Kryetare e Grave të Kosovës. Aty ishte angazhim edhe më i madh. Përfaqësojshe ni komb, ni popull, ni gjini, u dashke me qenë shumë punëtore, shumë frytdhanëse për me mujtë me prosperu edhe me... se nëpërmes meje, unë përfaqësojshe gruan e Kosovës, normal sidomos gruan shqiptare. Kur shkojshe në republikat tjera ose u takojshim, t'kqyrshin me ni sy shumë kritik, si dukesh, si shprehesh, si sjellësh, ndofta edhe si han bukë n'tavolinë, qysh e kap pirunin, qysh thikën. Se ka pasë, kena pasë paragjykime shumë t'mëdha, sidomos për popullin kosovar, a për gra mos t'flasim.

Kështu që, ka qenë një angazhim shumë i madh. Kur n'atë kohë edhe bashkëshorti im ka qenë shumë aktiv si ekonomist. Ai ka qenë një ndër ekonomistët ndoshta n'gishta të Kosovës, një ose dy. Edhe ai Komision Kadrovik e ka caktu Sekretar për Ekonomi³ pranë Këshillit Ekzekutiv të Kosovës. Gjatë periudhës t'tij ka qenë ni gjeneratë anëtarë, sikur tash që thojnë, qeverisë. Njerëz ma eminent të Kosovës të cilët janë arsimu, sidomos jashta Kosovës. S'ka pasë fakultet, s'ka pasë universitet e me kry fakultetin me ni republikë tjetër ose me ni shtet tjetër është dashtë me punu shumë, e me marrë dije sikur ajo sungjeri që mbushet ujë qashtu edhe ata. Ai ka qenë dy mandate Sekretar për Ekonomi. Ka punu shumë.

Mas luftës i kam thanë ni personi... “A ata kanë qenë komunist”, “Kqyre djalo çka t'preksh në Prishtinë e në Kosovë, reza e derës është merita e qasaj gjenerate”. Duke fillu prej ndërtimit të Radio Prishtinës, po e marrë vetëm në Mitrovicë [Prishtinë], ndërtesa e Odës Ekonomike, Pallati i Rinisë, Rilindja, po e dini ku osht’?

Anita Susuri: Po, po.

Bahtije Abrashi: Mandej Radio Prishtina, Pallati i Rinisë, Radio Prishtina, infrastruktura, spitali, universiteti, bibliotekat. Krejt është merita e qasaj gjeneratës në krye me bashkëshortin tim Aziz Abrashin. A mandatin e dytë prapë ka pasë nevojë, qiky Komisioni Kadrovik e zgjedhi për s'dyti Sekretar për Ekonomi. E meritat e tij janë nivel kosovar. Disa gjigande që janë ndërtu në çdo komunë të nivelit të Trepçës në Pejë, ka qenë fabrika e akumulatorëve, në Gjakovë fabrika e tekstilit, fabrika e, tash në moment s'po m'kujtohet. Në moment s'po m'kujtohet. Në Prizren “Filigrani”, në Gjiilan fabrika e akumulatorëve, krejt qat' kohë janë ndërtu. Qaty janë punësu krejt kosovartë edhe kosovaret.

² Sot shkolla “Faik Konica” në qendër të qytetit të Prishtinës.

³ Pozitë udhëheqëse në Krahinësn Autonome të Kosovës ekuivalente me pozitën e ministrit të ekonomisë.

Por, ka qenë ni revolucion shumë i madh. Në Ferizaj ka qenë fabrika e orendive, i ka pasë 2000 e kusur punëtorë. Ka falimentu deri dikund edhe është dashtë me u mbyllë fabrika. Ai sikur Sekretar për Ekonomi, ministër, ka thanë, “Unë do t’shkoj atje, nuk lejoj me u mbyllë fabrika”, edhe vullnetarisht ka shku. Ka punu ka dymbëdhjetë orë...

Anita Susuri: Si drejtor apo?

Bahtije Abrashi: Si drejtor. Ka qenë punëtor shumë i madh. Në Ferizaj kur t’shkoj thom, “Jom bashkëshortja”, apo janë fmitë, me mburrje e thom se ata të gjithë e dinë. Kështu që, nuk falimentoi fabrika. Filloi me ndërtu me t’madhe. Prodhimet i shitke në Amerikë, në Itali, në Zvicërr. E ndërtoi rrjetin. Ata kanë punu kah dy-tri ndrrime për me mujtë me mbri sa ma shumë me u shitë prodhimet e orendive.

Anita Susuri: Ju e keni edhe nifarë roli në ndërtimin e Pallatit të Rinisë me i bindë qytetarë. Qysh ka qenë kjo?

Bahtije Abrashi: Pallati i Rinisë është marrë si shembull, është ndërtu në Sarajevë edhe kena marrë ni iniciativë disa, si une Kryetare e Grave të Prishtinës, edhe shumë njerëz tjerë që kanë qenë në atë kohë në Prishtinë. Ka qenë drejtori, Kryetari i Komunës Nazmi Mustafa, një ndër inxhinierët e parë, dhe kam qenë në pleqësinë e qatij forumi. Për me mujtë me e ndërtu Pallatin e Rinisë, roli im edhe i të tjerëve ka qenë... se atë pallat nuk kena pasë pare me ndërtu, është dashtë me vetëkontribut. Edhe kena shku nëpër bashkësi lokale me organizatat punuese në organet shtetnore, se ky popull duhet me dhanë ni vetëkontribut me e ndërtu. E ajo është aprovu në Kuvendin Komunal të Prishtinës sa kam qenë Kryetare e Grave të Prishtinës. Edhe është ndërtu Pallati i Rinisë.

Ai është pallat i Prishtinës i ndërtuar me vetëkontribut. Atë nuk mundet kërkush me tjetërsu, as me u shitë, as me u ble se është pronë e qytetarëve të Mitrovicës [Prishtinës]. Ka qenë një agjirim në nivel t’komunës.

Anita Susuri: Në vitin ‘84 thatë që jeni zgjedhë Kryetare e Gruas që ka qenë kjo e Konferencë e Gruas të Kosovës edhe deri ‘89-tën po m’duket ka qenë ky rol.

Bahtije Abrashi: Katër vjet.

Anita Susuri: Po në ndërkohë bashkëshorti ka punu edhe në Trepçë. Qysh ka ndodhë? Ai vazhdimisht ka udhëtu, sigurisht po them ka udhëtu. Qysh ka qenë për to kjo? Domethanë, ju si bashkëshorte si e keni pa këtë rol që e ka pasë? Ka qenë ni përgjegjësi shumë e madhe se Trepça e treta ka qenë në Ballkan. Qysh e keni pa ju kta? Qysh ka reflektu kjo?

Bahtije Abrashi: Po na edhe si vendas mitrovicas e kemi ndje ni nevojë që duhet me kontribu edhe ma shumë për Mitrovicën. Thashë, Komisioni Kadrovik i atëherë, Krahinës Autonome të Kosovës e ka caktu me shku. E unë pak para tij kam qenë Kryetare e Grave të Kosovës. M’thirrën, “Hajde duhesh me shku me u bo kryetare”, normal është dashtë në bashkëpunim me bashkëshortin. Mas tri-katër dite po

i them, “Duhna me dhanë përgjegje”, tha, “Do ta them edhe niherë, unë e di çfarë gruje kam. Shko, po t’lypë shoqnia, po i duhesh shtetit. Urdhno shko”.

Kena pasë mirëkuptim shumë të madh në mes veti. Ndofta unë i kam marrë disa përgjegjësi familjare barrë për veti për me, mos me i pengu atij. Në shpi kur t’vjen me pasë kohë me pushu, me mendu për t’ardhmën e punëtorëve të Trepçës. Ai po ashtu ka qenë punëtor i madh sikur në Fabrikën Tefik Çanga edhe në Trepçe. Saqë ka mrri me i rritë rrogat deri 1200-300 marka një minatori. Është përkushtu shumë për punëtorë, për Trepçën, për Kosovën.

Anita Susuri: Po, shumica e minatorëve që i kemi intervistë në nifare forme e përshkrujnë atë periudhën kur zotëri Aziz ka qenë n’krye të Trepçës, si periudhë e artë e Trepçës.

Bahtije Abrashi: Qata thashë, ka mrri.

Anita Susuri: Edhe bashkëshorti ju j ka pasë kontribut t’madh, po qysh ka reflektu kjo? A ka pasë pastaj edhe angazhime tjera ose kohë?

Bahtije Abrashi: Ai, [Burhanin \[Kavaja\]](#) e ka pasë kojshi, e ka pasë krah të djathtë edhe ai ka qenë edhe drejtor në Elez Han. Mandej e ka thirrë, kur ka shku drejtor në Trepçë. T’u e vlerësu punën e tij se ai osht’ inxhinier, e ka marrë mas veti edhe e ka çu drejtor në Stantërg. Ata kanë bashkëpunu shumë. Kështu që, kanë mrri bashkë suksese shumë të mëdha. Tash po e marr ni detal. Nuk e kanë pasë lehtë. Gjithmonë kanë qenë në shënjestër të Serbisë se kanë fillu mos me mujtë me shfrytëzu Trepçën qysh e kanë shfrytëzu ata.

Shembull, Trepça ka prodhu edhe akumllatorë në Mitrovicë, ka qenë fabrika e akumllatorëve edhe në Gjilan. Ushtria deri në atë kohë i kishte marrë akumllatortë në nivel jugosllav pa asni dinar. Edhe bashkëshorti im ia ka ndërpre. Vetëm me berzën ndërkombëtare. Na dikujt duhet me ia shitë, na ma s’pari ia shesim juve është e vërtetë po. E shumë e shumë gjana, jo të arit, jo t’argjendit. Kështu që, kanë fillu shumë sene me ua shkurtu, se nuk bon kështu.

Në atë kohë hin një politikë shumë e vështirë. Kanë fillu çrregullimet në Kosovë, mas kushtetutës, mas dhetë vjet të arriturat masi është aprovu kushtetuta, mas vdekjes së Titos merr iniciativë Kryesia e Serbisë me i bo ndryshimet në kushtetutën në Kosovë. Me i bo ato ndryshime të kushtetutës ka qenë punë e madhe edhe Kryesia e Kosovës ka mbajtë mbledhjen në Gërmi, ka qenë villa e Kuvendit të Kosovës ku janë ardhë delegacionet prej republikave, shteteve tjera. Aty ka qenë ni vend ku i kanë pritë edhe ku janë zhvillu bisedat e krejt. U majtë mbledhja e Kryesisë të Kosovës.

Simbas funksionit tim si Kryetare e Grave kom marrë pjesë edhe une. Ajo ka qenë ni mbledhje e randë. Ka ardhë në delegacion Pera Kostić bashkë me shumë t’tjerë edhe e dhanë ekspozenë pse po dojnë me ndrru kushtetutën e Kosovës. Thojnë veç një korrigjim i vogël e mandej. E ata pse kanë dashtë me ndrru kushtetutën e Kosovës ka qenë se në kushtetutë të Kosovës ka qenë në atë kohë pjesë... Krahina Autonome e Kosovës, pjesë konstituive e Jugosllavisë. E kena kalu Republikën e Serbisë, kështu që

kena qenë t'barabartë me republika tjera. Kjo atyne iu ka pengju, se s'kanë mujtë me i zhvillu ato aktivitetet e mrapshta që i kanë zhvillu ktu.

Në atë mbledhje ka qenë shumë e randë. Kena reagu, ekziston sigurisht stenogrami, dokumentacioni se çdo gja në atë kohë osht' përcjellë. Unë kom reagu shumë ashpër edhe boj pyetje, "Sikur me pasë qenë gjallë Titoja", shoku Tito atëherë, "Me pasë qenë gjallë Eduard Kardeli", që ka qenë truni i Jugosllavisë, ai ka dhanë shumë kontribut në hartimin e Kushtetutës së Kosovës, "A kishit me marrë këtë iniciativë që e keni marrë tash? Unë s'po pajtohem me këtë". Aty u bo ni rrëmujë, kush jom, tek jom, çka po mendoj, pse po e thom këtë. "Kushtetutën e ka aprovu Kuvendi i Kosovës, Kuvendi i Kosovës në qoftëse ka vërejte duhet me i dhanë, jo ju". Por, gjetën mbështetje edhe i bon ndryshimet t'cilat na kushtun shumë.

Pjesa e Tretë

Anita Susuri: '89-tën, fillimisht '88-ën n'fakt ka fillu në nëntor marshi...

Bahtije Abrashi: I minatorëve.

Anita Susuri: I minatorëve të Trepçës. A ju kujtohet juve ajo ditë?

Bahtije Abrashi: Qysh jo. Në krye të atij marshit ka qenë i ndjeri bashkëshorti im, ka qenë Burhani, ka qenë [Ibushi \[Jonuzi\]](#), ka qenë [Avdija \[Uka\]](#). Oh kanë qenë edhe shumë e shumë tjerë, s'po m'kujtohen emrat. Me fotografinë e Titos, me flamur të Jugosllavisë edhe kanë tregu ni revoltë, ni paknaqësi t'cilën mas '74-shit që e manifestunë në Kosovë. Po e përsëris fjalën, "Shqiptarin mos e arsimo, mos e punëso. Shkatërroj dhe likfidoj". Qikjo ka qenë motoja e Republikës së Serbisë edhe programi i Millosheviqit. Të cilët krejt t'zezat që i kanë bo me qit' thanje. Këtë thanje e kanë pregatitë Akademia e Serbisë, njerzë shumë eminentë, siç ka qenë në atë kohë Çubriloviç.

Anita Susuri: Ishim t'u folë për marshin kur ka fillu, na tregutë që ka qenë me fotografinë e Titos dhe me flamurin. Po më intereson si e keni përjetu kur e keni pa që po ndodhë kjo?

Bahtije Abrashi: Ktu ndoshta edhe po m'kapin emocionet se s'ka qenë lehtë. Kanë ardhë n'kamë në qytet janë vendosë, në Pallatin e Rinisë. Aty e kanë lypë, se ka qenë kryetare e partisë në atë kohë Kaqusha Jashari. Ajo ka dalë me ni platformë se nuk do t'ndryshojë, nuk munden, situata e krejt, nuk do t'bohen ndryshime të kushtetutës. Por me qata nuk janë ndalë, kanë vazhdu grevën. Veç ta ceku, greva nuk ka qenë sociale, greva ka qenë politike, se e ka ni konotacion tjetër sociale, tjetër politike.

Dikush është i ndjerë, dikush është hala i gjallë, dikush është gjysë. Shtatë ditë edhe shtatë netë kanë nejtë në minierë. Me ta kanë ndejtë edhe udhëheqësia edhe drejtori gjeneral Aziz Abrashi me ta. Nuk është nda kurrë prej minatorëve. Tri netë edhe tri ditë fare s'ka ardhë në shtëpi. Të tretën natë ka ardhë me u ndrru. Unë veç kur e kam pa ish zbardhë, ish thi. Aty e kam pa se sa e ka vështirë. Rrobat, teshat e tij kanë qenë krejt t'gavrune, thu ti që i ka hangër diçka ose ua kanë gjujtë diçka prej substancave

t'cilave kanë qenë shumë t'randa në minierë. Se minatorët i kanë pasë rrobat e punës që kanë qenë ma rezistente, e ky jo.

Edhe unë në atë kohë kam qenë në Kryesi të Lidhjes Socialiste, kryetare, edhe po i tregoj si është gjendja jashtë. Edhe mas tri dite ia dhanë epitelin se ata janë irredentista. Fjala irredentist është shumë e randë. Janë mundu me tregu që nuk janë irredentista, po jo. Ditën e pestë kur ka ardhë në shtëpi ka qenë ankthi i madh sa t'u dhimbte bashkëshorti, t'u dhimke baba i fëmijëve, ni drejtor i ni gjigandi t'madh, ni ekonomist, ni punëtor i madh, i pashoq. Edhe po i them, "Ti je drejtor gjeneral s'ki nevojë me ndejtë aty me minatorë".

Kanë ardhë të Komitetit Qendror edhe Republikan në bisedë me i bindë minatortë me dalë. Kryetar ka qenë Stipe Šušteršič. Ai është ballafaqu shumë randë me të. Pse nuk ka dashtë me i qujtë irredentista se kërkesat e tyre janë me vend. Kanë qenë dymbëdhjetë apo nëntë kërkesa të cilat s'kanë pasë kurgjo t'bajnë me fy dikë, por kanë lypë t'drejtat e veta edhe kanë lypë të drejtat e t'gjithë shqiptarëve në Kosovë. Nuk bon kaq me na poshtnu. Por nuk ka pa... ato janë bindje, bindjet e veta i kanë formu, programin e vet edhe ata duhet me realizu.

Edhe une pak vetjake, po i them, "Duhesh me lshu dorë se ki me pasë pasoja t'mdhaja n'shtëpi", tha, "A ke punu ti n'arsim?" Thashë, "Po", "A i kishe lanë ti nxansat tu n'mëshirë të dikujt?" Thashë, "Jo", fillova me qajtë. Tha, "Edhe une s'muj me i lanë puntortë e mi, minatortë e mi". Ai ka qenë shumë i lidhur me ta. Do t'kaloj në diçka tjetër. Ai çdoherë, bile niherë n'mujtë ka shku në kuzhinën e minatorëve me e kontrollue ushqimin. Ka hy në sallë i palajmërum, e kanë servu ushqimin. Ka shku te ni minator e ka pa ushqimin, ka thanë, "Kjo është e imja, s'është e jotja". Ndoshta dikush edhe s'e ka njoftë ka thanë, "Kush je ti?" Ai tjetri, "Ej, drejtori gjeneral". Ka qenë shumë i lidhur. Këtë po e ilustruj për arsye se ka qenë shumë i lidhur për ta.

Edhe atë natë kur minatortë kanë dalë jashtë, në Beograd Millosheviqi ka mbajtë ni tubim popullor shumë të madh edhe aty është kërcënu se do t'i burgosim. Ata kishin pregatitë terenin me i burgosë veç kanë pritë me dalë. Edhe kanë ardhë dikun para mëngjesit, ai i ndjeri ishte smutë kishte temperaturë, i dhimte fyt se n'kushte shumë t'vështira. Erdhi policia, tre policë në derë, të mdhej, të armatosur. Normal në gjuhën serbe, "Mirëmrama!" "Mirëmrama!" Unë po iu them, "Urdhëroni?" "A është drejtori gjeneral ktu?" Thashë, "Po, çka po ju duhet?" "E kena urdhërin me e thirrë në bisedë informative". Veç e pashë sa është sahati. Thashë, "M'falni, ai është smutë, kur t'i kalon vjen vet". U konsultun me dikë me toki-voka. Ata thanë, "Jo, merrne".

Hyna n'dhomë e çova prej gjumit, s'ka qenë lehtë, edhe ia dhashë. I ka pasë niparë bregë t'leshta i veshi, ni pullover të leshtë, si me armatosë. Shkoi në... e morën. Prit që po e kthejnë, se kthehet thanë. Na mashtrun. Prit që po e kthejnë, prit që po e kthejnë. Gruja e Burhanit po m'thirrë në të njejtën kohë, po m'thotë... po kanë mujtë edhe Burhanin me e gjetë aty, se erdh, i thashë, "Hajde me hangër darkë", se s'e kishte grunë në shtëpi. Ai tha, "Po shkoj n'shpi po pushoj". E kishin marrë t'njejtën kohë edhe Burhanin edhe Azizin.

Kur n'mëngjes... kta e pritshin babën, e po thojnë, “Baba jonë ka meritu lavdata. Çfarë shteti me ardhë me e shti n'burg?” Përjetun shok edhe i zuni gjumi. Unë meta në shtëpi, e kisha kunatin aty. N'mëngjes erdhi shoferi me e marrë me e çu n'zyre. Dragani. Ka pritë poshtë, ai kurrë n'jetë s'osht' vonu edhe është çuditë. Kur erdhi naltë po thotë, “Mos është smutë drejtori?” Thashë, “Jo, hyn brenda”. Hyni. Thashë, “Drejtorin e kanë marrë, qishtu qishtu”. A din si ka qajtë? Si me qenë fëmi. Tha, “Kur atë e kanë marrë n'burg... a ka në Kosovë njeri ma të sinqertë edhe ma punëtor?” Thashë, “E murën”. Ka ndejtë 14 muj në burg.

Mas pesë dite... s'ka qenë lehtë për familje për nanën e tij, për vllazën, për motra, për fmi, për krejt Kosovën. Qysh me e marrë Azizin n'burg? Mirëpo, ata ma t'fortë, kishin bo strategjinë. Edhe kishte ba grevë urie. Katër-pesë ditë s'ka hangër, ma tani s'ka dashtë me jetu. Ka qenë n'qeli vetëm. Kish pasë frikë se mos e kanë marrë Lindën n'burg, se kjo ka punu n'televizion, ka udhëheq emisionet e rinisë. E ka pasë edhe ni emision mjaft politik t'cilin e kanë transmetu edhe krejt televizionet e republikave, Kroacia, Bosnja, Sllovenia. Edhe është frigu mos e kanë marrë edhe këtë n'burg. O frigu edhe për mu.

Edhe po m'thirrë ky kryetari i gjyqit, Asllan Baruti, po m'thirrë n'telefon se na vendas. Po m'thotë, “Të lutem eja se e kam ni bisedë me ty edhe mos i trego diku tjetër që t'kom thirrë”. Unë e kalla kerrin, për 20 minuta kam mri në Mitrovicë edhe drejt te kryetari i gjyqit. Po edhe ai e ka pasë shok, po është dashtë. Thotë qishtu, qishtu, “Ka bo grevë është shumë keq. Ksi raste thirret nana, baba. Por, na e pamë të arsyeshme me t'thirrë ty me bisedu me të”. “U bo”.

Në gjyqin e Mitrovicës është shtatë kat, shtatin kat hypa në kamë, s'kishte lift, ashensor. Edhe hyna me ni zyre ku ishte ni tavolinë e dhomës edhe ni tavolinë me tri, e vogël me tri fotele. Drejtori i burgut... unë si hyna u ula n'tavolinë të burgut se u lodha, qata e pata ma afër. Tha, “Jo, mos rri aty”, thashë, “Pse?” Thashë, “Mirë e kam ktu. Jom lodhë, s'po muj ma me u çu”. “Të lutem dil n'këtë fotele, dil n'këtë fotele, dil n'këtë tavolinë”.

Kujtoi që ka punë me ndonjë grua analfabet. Kam pa filma, kom lexu libra qysh i përgjojnë. Ai doli me shku me marrë të ndjerin Azizin. Unë si e kom çu fotelen naltë, kur po e shoh ni mikrofon i vogël. Plus muri i shpumë, ajo gajtani n'murin tjetër. Erdhi drejtori i burgut edhe me të e pata ni duel. Thashë, “S'du me ndejtë n'këtë fotele”. Tha, “Po, pse? Të mirë e ki”. Thashë, “Ti ulu ktu le t'përgjojnë ty çka po folë e jo mua, se unë s'kam çka me folë. Unë nuk jam njeri kundër shtetit, as ai s'osht'”, edhe u çova. “T'lutna, t'lutna”, veç sa s'qajti.

Erdhi i ndjeri edhe unë meniherë po ia boj {shpjegon me duar}, “Po inçizohet”. Ai kishte ni letër tha, “Ma murrë mendja”. Aty patëm ni bisedë konstruktive se ai duhet me pre grevën. Për hir të minatorëve, për hir të popullit, për hir të fmive edhe mu si bashkëshorte. Pse me vdekë me hipotekë? Duhesh me dalë n'gjyq edhe me tregu të vërtetën, “Mos i merr n'qaf edhe minatortë”. Kur i kam thanë, “Mos i merr n'qaf edhe minatortë”, po m'duket në atë moment e ka ndrru mendjen. Ka thanë, “Po, du me hangër”.

Në letër po m'shkrun msheft prej drejtorit të burgut, “Jom frigu për ty, për Lindën”. “Na jena shumë mirë”, unë tash po i shkruj, “Na jena shumë mirë. Mos ke frikë për neve”. Edhe drejtorit tash, ndoshta edhe kjo është interesant. Po i them, “Sherafedin,” e Shero e thirrshin se vendas, “shko bleja dy byrekë

edhe dy jogurta le t'han njeri bukë". Tha, "Ti po m'urdhnon?" Thashë, "Po unë tjetër kond s'kom, veç ty". Doli ai. Nejse, e ka angazhu dikon tjetër edhe e pruni. Filloi me hangër. Kështu që, edhe ajo ka qenë shumë vështirë. Ish dobësu shumë, me sy...

Anita Susuri: A ka qenë qajo hera e parë që e keni pa prej që ka hi n'burg?

Bahtije Abrashi: Po, hera e parë. Vështirë ka qenë.

Anita Susuri: Qysh ju ka dokë?

Bahtije Abrashi: Ish dobësu shumë, pa rru, edhe ashtu ishte n'minierë po ka qenë stoik edhe ai. Por kena pasë ni respekt shumë t'madh të njani-tjetrit, besim edhe më ndëgjoi. Mandej kena qenë n'vizita të rregullta ni herë në javë. Nuk m'lejshin me shku vet e treta, e katërta, vetëm vet e dyta. E merrsha Lindën, mandej erdhi radha me e marrë djalin. Po ndoshta kom gabu, s'kom bisedu me të, s'i kom tregu, s'e ka ditë veç ka pa filma diçka qysh është burgu. Edhe kur e ka pa babën e vet n'grila, veç ka bërëtitë, "O s'ka merit baba jem kështu", edhe i ka ra t'fikët. Ai e pa djalin, m'pa mu. Ishte aty kujdestar mjeku. Erdhi, erdh n'veti. Po s'ka mujtë me ardhë n'veti djali disa ditë. Të njejtën ditë shkum në Mitrovicë te nana ime, e ndjera. Ai prej shqetësimit e thej kamën. Dul n'oborr me lujtë me fëmitë e vllaut, e thej kamën.

Pasoja gjithë, gjithë ka pasoja. Krejt intelektualët në Kosovë, sidomos n'qytet, kanë pasë ni dozë të frikës. Tash po i marrin, tash po i marrin. N'atë kohë i kanë arrestu 260 intelektualë të fakultetit, të ekonomisë, t'mjeteve të informimit edhe i kanë çu në burgun e Nishit. Ndër të tjera, prej grave kisha qenë une në listë edhe e ndjera Drita Dobroshti. Kush na ka shpët, po du me vdekë edhe nuk e di.

Vetëm m'ka thirrë Kryetarja e Grave të Bosnjës në telefon edhe m'ka thanë, "Thirrëm ti mu prej ndonji telefoni të kojshive". Se telefoni jonë është përgju. Për përgjim të telefonit ni nxanës i imi, inxhinier në postë ka ardhë edhe m'ka thanë, "Msuse, telefonin po ta përgjojnë". Edhe kom shku prej kojshive e kam thirrë Elmazën, "A e din që je n'listë që kanë me ju arrestu edhe ty edhe Drita Dobroshtin?" Unë i thashë, "Jam ba njejtë, le t'më arrestojnë". Edhe nime u bana njejtë.

Po qysh shpëtum, a intervenun kto kryetaret të republikave tjera, se i kom pasë raportet shumë t'mira edhe me të Sllovenisë edhe me të Bosnjës edhe me të Kroacisë. Tash po dal me ni temë tjetër, a bon? Kryetarja e Grave të Kroacisë, doktor profesor sociologe, e kam pasë mysafire në Prishtinë edhe kur e kam përcjellë m'ka thanë, "Kosovën e shpëton vetëm nataliteti edhe universiteti". Edhe tash po e jepi ni porosi, edhe ma tutje vlen kjo se Kosovën na shpëton dija, universiteti edhe nataliteti. Nataliteti ka ra me t'madhe, por prapë jena në favor na ma tepër se republikat tjera.

Anita Susuri: Ju në atë kohë kur ka vazhdu gjykimi keni pasë ni kërkesë që me qenë gjykimi publik...

Bahtije Abrashi: Po. U flitke, po çka u flitke edhe u realizojke. Se gjykimi i ktyne 14, të 14-ve që i kanë taku minierës do t'bahet i msheftë. Dojnë me çelë ni tunel prej burgut deri te gjykatorja është afër në Mitrovicë edhe mos me pa kërkush. Se ishin iredentista me nenin 114 është edhe dënimi me vdekje.

Atëherë si bashkëshorte e kam thirrë kryetarin e Jugosllavisë, ka qenë [Janez] Drnovsheku, hala i kisha lidhjet une, se “Pranom në bisedë, kam nevojë me ardhë”. Të nesërmen m’ka thirrë n’telefon sekretaresha e vet edhe m’ka thanë, “Kryetari m’ka thanë munësh me ardhë masnesër në ora qikaq”. E kam marrë Lindën, djalin, s’kam pasë fuqi me vozitë deri në... se unë jam, 36 vjet kom vozitë. Edhe kom shku në Beograd.

Ia kom përgatitë ni raport katër-pesë faqe se ku muj me ia shpjegu krejt, njeri s’ka kohë me t’dëgju. M’ka kqyrë, e ka pytë Lindën, “Sa vjeçe je, çka ke kry, çka punon?” Kjo i tregoj historinë e vet, i tha se jam gazetaresha. I tha, “T’ marr në Slloveni si gazetaresha”. Edhe ai më premttoi, “Nuk kom fuqi ma t’madhe vetëm me u bo gjykimi i haptë”. Edhe qashtu u bo. Ka zgjatë gjykimi shumë. Vështirë ka qenë shumë. Shkojshe e shifshë njerin të lidhun, të rraskapitun. Çdo gja ke mujtë me marrë me mend, por që shkon në burg ni njeri i përkushtun për Jugosllavi, për shtet. Ai s’ka punu për pushtet, por ai ka punu n’atë kohë për shtet. Qashtu kena qenë t’përgatitun, se Kosovës i duhen njerëz për shtet e jo për pushtet. Por, kanë vendosë tjetërkush për neve.

Anita Susuri: Çka ka qenë mendimi i juaj në atë kohë? Çka keni mendu që ka me ndodhë? Çfarë vendime kanë me marrë?

Bahtije Abrashi: Masi kam qenë te Drnovsheku kam ndrru mendimin. Se m’dha premtime t’forta edhe u bo gjykimi i haptë. A merre me mend gjykatës ka qenë Ismet Emra, shok, cimer i tij në Beograd si studentë. Edhe ai s’e ka pasë t’lehtë. Edhe atij ju kanë kërcënu edhe qytetartë se, “S’guxon me i dënu”. Besa i kom çu edhe unë ni kërcënim, “Kujdes çka po bon!” Iu ka kërcënu grua e vet, iu kanë kërcënu fëmijë e vet. Kështu që, edhe ai ka qenë në zaval të shpirtit i ndjeri.

E n’atë moment kur e komunikun se u lirun, krejt qyteti ka qenë n’kamë. Krejt Kosova ka qenë n’kamë, çka po ndodhë...? Unë në gjykatore kom shku me djalin. Linda ka qenë ma vulgare, ma dinamike, ma eksplozive. Edhe thojsha me e marrë, larg koftë me e dënu, po m’i ndodhë diçka edhe çikës. Në shtëpi i kisha vllaznit, ni shok të tij prej Gjakovës, Nesim Batinën erdh ai me përcjellë gjykimin. Edhe thashë, “Hajde te tradhtojmë Lindën, mos me ardhë n’gjykim”. “Çka me bo?” “Hajde po qesim short”. E ja bom, i ra shorti me ardhë Gazmendi me mu.

Gazmendi kishte marrë, se ai ka qenë pedant e majke kravatën, e ka dashtë kravatën, ka pasë shumë kravata. E kishte marrë ni kravatë n’xhep. Edhe filloi gjykimi, Gazmendi ma kish shtrëngu dorën e unaza m’ka mbetë knej. Qaq shumë ma kish shtrëngu dorën, sa që m’hupi orientimi e m’vijke gjyna me i thanë Ishoma dorën. Po ai tu e shpreh atë revoltë, atë ankth. Edhe erdh, i kanë liru. Qyteti ka qenë krejt n’kamë, nuk i kanë lanë me u afër gjykatorës.

Linda ka qenë diku n’mes qytetit me shokë e farefis. Linda ishte, s’e kanë lanë me u afër, ka qenë n’mes t’qytetit. E ka lshu radion edhe n’radio e ka dëgju gazetarin Musë Preniqi, gazetar i Radio Prishtinës ka qenë... e unë e kam pa n’sallë që i ka kcy krejt karrigat edhe tavolinat për me dalë sa ma shpejtë me lajmëru. Edhe kjo ka vrapu qaq shumë, sa që edhe sigurimi është çuditë kur e kanë pa në koridor të sallës të gjykimin. Veç ia kom ni zanin, i kanë thanë serbisht, “Ku po shkon? Ku po shkon? Qysh ke ardhë deri ktu?” Kjo tha, “Une kom fluturu edhe kom ardhë deri ktu”.

Mandej, dikush aty ka pasë sigurisht, e kanë qetësu edhe i kanë thanë, “U liru”. Kjo dojke me pa babën, po mandej prapë i tërhjekën, i çunë në burg. E Gazmendi deshi me ia vu kravatën meniherë. Normal s’e kanë lanë. Shkoi, u kry procedura. E kom fotografinë t’pikturume që kish fotografu ndonjë gazetar. Krejt qytetartë kishin dalë, ballkonat plot. Mirëpo, përreth krejt policia. Edhe vendosën mos me na lanë me kalu nëpër qytet, po me shku andej ka rruga si tranzit kah Dedin Kërshi dhe me ardhë në Prishtinë.

Vozitke Gazmendi. Kur kena ardhë te vorrezat, s’e di ni fuqi ai e kishte nanën gjallë edhe po i them, “Mos ec drejt, kthehu n’qytet”. “Po mamë, po na kthejnë”. “Le t’na kthejnë”. Edhe shkum drejtë para derës t’shtëpisë të ndjerit. U taku ai me nanën e vet, asaj i ra të fikët, me farefisn. Për pesë minuta ka qenë si me qenë *meeting* para shtëpisë. Qaq shumë kanë qenë njerëz të grumbulluar. Linda ka vazhdu me dajën e vet për Prishtinë me çelë derën. Na kena qenë afër Shkollës në Breg të Diellit te Furra e Qerimit. Aty është ni pllato e madhe.

Kur kena ardhë me qindra njerëz. I kena filma të inçizum. Hymjen e kishin shtru krejt banortë e hymjes edhe shoqnia tjetër tepiha t’kuq. Plus e kishin bo krejt, se atëherë ka qenë koha e jorgovanit, me lule me jorgovana. E kjo m’thirri në Mitrovicë m’tha, “Nanë t’lutem ktheni ma shpejtë se mos po ndodhë diçka se janë grumbullu shumë njerëz ktu” edhe unë po i them... vjehrra e ndjerë, “Po mos e merrni kaq shpejtë”, “Jo, tash po e marrim për gëzim edhe ti vjen mas tij”. Erdhën. Kështu e kanë qit’ {shpjegon me duar} deri ka hy brenda.

Doli n’ballkon i përshëndeti. Pat’ edhe shumë fëmi, nxanësa të shkollës. I kisha unë nja dy-tri paketime bonbonjera edhe e çova ni fëmi, ni nip me ble krejt çka ka bonbone, sheqera në vetshërbim, “Birmi naltë”. Edhe po i them, “Qitjau”. Ai prej dritarës krejt i ka gjujtë, i ka gjujtë, i ka gjujtë. Menzi u qetësun, po na rrethoi krejt policia. Kështu që, vështirë ka qenë. Ndoshta po i shpjegoj pak ma lehtë, por s’ka qenë lehtë, s’ka qenë lehtë.

Edhe këtë detal do ta tregoj. Shkum... n’mramje nana ime e ndjerë po i thotë nuseve, “Hajde bre pshtjellni, merrni dy-tre kilogram mish pshtjellni do sarme. E lshun, duhet me u gëzu, me hangër. Edhe s’e lshun, duhet me hangër”. Ishte pasiguri shumë e madhe. Erdhi qiky shoku prej Gjakovës, i pa nusët t’u i pregatitë sarmet. M’kujtohet hipi naltë se n’kat e bërtitke, “Gzim, gzim, gzim. Kanë me lshu, qe po pregatitet”. Qe qishtuqe. Ndoshta për shikus e mërzitshme, po për mu përjetim.

Pjesa e Katërt

Anita Susuri: Pas daljes nga burgu të zotit Aziz, tregutë që keni pasë edhe oferta me dalë prej Kosovës me shku diku jashtë.

Bahtije Abrashi: Mbasi që ka dalë ai prej burgut, kanë ardhë me mijëra njerëz me vizitu që ka dalë prej burgut. Me 2 maj [1990] më kujtohet atë vit, një mijë vetë kanë kalu nëpër shtëpinë time, që kanë ardhë me vizitu. Mirëpo, ka pasë shumë oferta prej mysafirëve, prej dashamirëve, prej njerëzve që e

kanë dashtë, njerëzit që e kanë njoftë si njeri t'madh. Ofertë për me shku në Gjermani, ofertë me shku në Zvicërr, disa oferta momentalisht. Ishim n'dilemë a me dalë, a jo? Se kena me i pasë pasojat shumë t'mdhaja. Ai mbetë pa punë, unë mbeta pa punë, Linda punojke në televizion mbet pa punë. Edhe familja e gjanë për me na tregu se çka mundet, çfarë represionesh munden me ju bo, tre vllazën m'i qitën prej pune, dy gra t'vllaznive. Kështu që... edhe ishte dilema n'shpi, a po dalim, a po rrijmë, a çka po bojmë. Nuk flejta tanë natën.

Në mëngjes po bisedojmë të katërtit, po thom, "Nuk vdesim uni. Unë di me qepë, e kam maqinën ulna qepi", unë e kam profesionin edukatore, u dashke me pasë ni diplomë për... "E çeli ni çerdhe, e kom sallonin e madh e boj çerdhe pesë-gjashtë fmijë, qe. Edhe ma në fund do të bohna taksist edhe aty fitoj. Ni gru taksiste". E kisha kerrin golf. Kështu që, i dhashë ni kurajo familjes t'mos dalim, po rrijmë. Po m'duket që ka qenë me vend, por ndoshta ndonjëherë edhe n'familje e kam pasë fjalën që ma ka çmu edhe burri edhe fmitë edhe ashtu mbetëm në Kosovë. Vazhdum punën. Falë Zotit punum, askush profesionin e vet por nuk hjekëm keq.

Anita Susuri: Para se me vazhdu tek vitet e '90-ta deshta me u kthy pak se m'tregutë ma herët për një ballafaqim që keni pasë në vitin '87 me Millosheviqin...

Bahtije Abrashi: Mas t'gjitha ktyne represaleve krejt, isha Kryetare e Grave të Kosovës edhe po m'thojnë, po ma bojnë ni ftesë me rend t'ditës kanë organizu gratë në Fushë Kosovë edhe me shku. Aty shkova une, nja dy-tri gra anëtare të Kryesisë të Konferencës të Grave, anëtarë të Kryesisë të Lidhjes Socialiste të Kosovës. Kanë qenë edhe të Komitetit. Shkova n'mledhje, kur hina në sallë të Fushë Kosovës, sigurisht kanë qenë 300 vetë. Aty ishte edhe Millosheviqi edhe krejt ata aty Millosheviqa. Edhe aty e shpalosën programin e tyre çka po mendojnë edhe ma tutje pasojat ndaj shqiptarëve. Me dëbim, me na qit' prej pune, me mbyllë shkollat, me mbyllë universitetin, organet ekzekutive, shtypin. Tmerr, tmerr.

Ndër të tjera, thojnë, se edhe ju gratë e Kosovës nuk doni kurgjo tjetër vetëm me lindë, "Jeni bo si makina lavatriqe, veç fëmijë po lindni. Fushë Kosova është djep i Serbisë". E shumë e shumë tmerre. Edhe e mora fjalën. Ka qenë anëtari i kryesisë një malazez Hujsiq. Kur e kom marrë fjalën tha, "Nuk osht' dashtë të kërcenohen hala ma shumë", thashë, "Le të kërcenohen, edhe unë kërcnohna". O Zot, kemi me ju bo kështu, kemi me ju bo kështu. E kur kanë thanë se Fushë Kosova është djep i Serbisë "*Kosovo Polje je srpska koljevka*" po e interpretoj serbisht. Kom thanë, "Në Fushë Kosovë, Fushë Kosova është një atyne djepave që përkunden në Fushë Kosovë. E aty përkunden shqiptarë, serbë, malazezë, rom e të tjerë".

Atëherë u kall edhe ma shumë salla. "Ju kurgjo s'dini, veç me lindë", edhe tash po thojnë, "Na dimë edhe metoda tjera. Krejtve kena me ju dhunu". E paskan pasë n'program t'vetin. "Ma s'pari kena me dhunu", se thojshin, "Fadil Hoxha i ka ofendu serbët". E unë dola dhe thashë, "Për qata që po ia mveshni Fadil Hoxhës e ka thanë, 'Më falni për atë që s'e kom thanë'". Edhe aty u kall salla. "Kena me dhunu grunë e Fadil Hoxhës". Kjo është me dokument...

Anita Susuri: Qesi deklarata n'mledhje ka pasë a?

Bahtije Abrashi: N'mledhje, me shumicë se 300 vetë. Horaz folshin {shpjegon me duar} as s'u përfillë rendi i ditës as kurgjo. "Grunë e tij, vajzën, nusën", me emër, "krejt shqiptarët, edhe ty". Në mënyrë horaz m'drejtohen mua {shpjegon me duar}. Edhe unë rash n'nivelin e tyne edhe po ju them, "Urdhno eja, afromu. Unë e kom në gjuhë. S'po ju vjen turp me ju ndi fmitë e juaj, me ju ndi gjeneratat e reja. Na e kemi kultivu Vllaznim-Bashkimin e ju shpreheni kështu". Nuk di çka kom folë, s'di me interpretu vetën po janë të inçizume edhe në televizione edhe policia e ka pasë të inçizume. Edhe veç që s'më rrehën. Mrapa meje ka qenë kamermani i Radio Televizionit të Prishtinës, Klllokoqi. Ai m'u ka afriu edhe po m'thotë atëherë, "Shoqe Bahtije, mrapa mos u friko unë jom ktu. E përpara nuk di". Domethanë, qasi atmosfere u krijë.

Erdhi shoferi im, u afriu se u tutke që po m'sulmojnë. Unë hiç s'u dorëzojsha. Ata banal, unë edhe ma banal se ish momenti që u dashke me ua kthy me të njejtën mënyrë. Është formu koridori kordon për me mujtë me dalë une prej mledhjes. E them se të gjithë kanë qenë Millosheviqa. Ka pasë aty gra, në Kryesi të Grave të Kosovës që është dashtë me u çu me reagu. Ka pasë anëtarë të Kryesisë të Lidhjes Socialiste asnjëni... po edhe ata serbtë njëri për tjetrin, kanë qenë funksione të Kosovës. Asnjëni s'janë çu me iu kundërvu edhe mos me u dhanë të drejta. Përqata kom të drejtë me thanë që krejt kanë qenë Millosheviqa. Aty u shpalos programi i Millosheviqit. Unë e di qysh kom ardhë në shtëpi.

Të nesërmen kanë thirrë prej Turqisë, kanë thirrë prej Gjermanisë, prej Zvicrrës se i kanë përcjellë lajmet edhe m'kanë pa në çfarë gjendje qysh. Po, a jom në shtëpi, a jom n'burg? Po s'e di pse kom shpëtu, shpëtova. Problemin tjetër, isha në Beograd në Kryesi të Konferencës së Gruas. Ishte rendi i ditës, iu përmbajtëm rendit të ditës. Kryetarja e Grave të Serbisë edhe të Maqedonisë, kategorikisht insistojsin me shti në rend të ditës edhe thanien e Fadil Hoxhës.

Kryetarja e Grave të Jugosllavisë ka qenë sllovene, Sofia, ajo thotë, "S'e kom rend të ditës edhe s'kom nevojë". Ata duhet në Kosovë me... e futën në rend ditës edhe Kryetarja e Grave të Serbisë thotë, "Kena me e fut", ndër të tjera thotë, "Ai është sikur Artukoviqi". Artukoviqi, është, ka qenë se u deké, ni ustash i Kroacisë i cili është dënu me vdekje. Edhe unë jom çu kom thanë, "Nuk pranoj ni kryesi në nivel të Jugosllavisë me ma krahasu legjendën time, heroin e popullit, Fadil Hoxhën me Artukoviqin". Edhe demonstrativisht e kom lshu mledhjen.

Por, unë s'di qysh kom shpëtu prej gazetarëve. Është e vërtetë që Kryetarja e Jugosllavisë ka qenë afër m'ka thanë, "Mos gabo tjetër diçka me thanë, veç kta që e the n'mledhje". Prej Komitetit Qendror të Jugosllavisë menzi kom shpëtu prej gazetarëve, deri jashta Beogradit më kanë përcjellë me lypë deklarata tjera t'miat. Por shpëtova.

Anita Susuri: E cila ka qenë ajo deklarata që ju ka pengu atyne?

Bahtije Abrashi: Qajo se i ka ofendu serbët se ata janë ma të lirë a diçka qishtu. A është e vërtetë se une kom ardhë, kisha në Kryesi të Lidhjes së Luftëtarëve, po unë e kam marrë mandej deklaratën e kryetarit të Lidhjes Luftëtarëve ka thanë që s'osht' e vërtetë. I kom marrë edhe tri deklarata tjera kanë

qenë serbë, oficera, kanë thanë s'osht' e vërtetë. Prandaj kom thanë, "Fadil Hoxha ka thanë, 'M'falni për qata që s'kom thanë'". Qikjo ka qenë reagimi im edhe në Beograd edhe në Fushë Kosovë.

Mandej, të nesërmen kur kom ardhë në zyre, s'po ia përmendi emrin, e kom pasë profesor edhe drejtor, edhe po m'thotë në zyre, "Oj çika jeme, a e dite që je nanë, që e ki burrin, që i ki vllaznit krejt?" Thashë, "Valla, niherë kom lindë, niherë kom me vdekë". Kur kanë ardhë anëtarët të Kryesisë, dy-tre serbë, "Qysh je paraqitë aq ashpër?" E krejt. Thashë, "Unë mendova që po hyni me m'përkrahë e me iu kundërvu edhe ju atyne, ju njejtë po mendojshit".

Mandej, masi e kanë marrë të ndjerin n'burg, une si anëtare e Kryesisë kom punu edhe tre muj. E kom pa krejt çka po zihet çka po bohet, po mas tre muje kom dhanë dorëheqje se s'jom pajtu ma me atë politikë dhe thojsha sa më shkarkojnë ata do t'kem pasoja edhe ma t'mdhaja. Kom dhanë dorëheqje prej Bashkësisë Lokale deri te organet ma të larta federative në Kryesi, "Ma nuk du me u marrë me politikë".

Anita Susuri: Qysh ka vazhdu pastaj jeta ju? Na tregutë për periudhën e vështirë që keni pasë n'burg që ka qenë zotni Aziz, keni marrë vendim me qëndru ktu. Qysh kanë vazhdu pastaj vitet e '90-ta?

Bahtije Abrashi: U dashke vet me u organizu. Fati që ka qenë solidarizimi i familjarëve dhe shoqnisë mes veti. Kështu që, s'kena lanë kërkond me hjekë keq. Po, edhe ajo ju ka pengu.

Anita Susuri: N'atë kohë, për mu po m'duket edhe ni, që e përmendet solidarizimin, ndërmjet minatorëve apo diçka ka qenë ni lëvizje "Familja e ndihmon familjen"...

Bahtije Abrashi: "Familja i ndihmon familjes" edhe mas saj në zgafellën e minatorëve është dhanë propozimi, një ndër ma t'ritë, me u pajtu që është gjaqet. Aty është merita e tyne. Edhe mandej janë organizu edhe janë bo pajtimi i gjaqeve në Verrën e Llukës me mijëra njerëz, se kanë qenë të mbyllur.

Anita Susuri: A jeni marrë me ndonjë punë pastaj pasi keni dhanë dorëheqje knej? Thatë që politikën e leni lanë.

Bahtije Abrashi: Pastaj kam shfrytëzu të drejtat e mia, kom dalë n'pension. Kam pasë pensionin t'mirë shumë edhe unë edhe, por edhe ata na ndërprejnë. Por, mandej filloi djali me punu në një sipërmarrje të Sllovenisë, kërkah. Duke na çmu familjen e krejt, na kanë ndihmu shumë njerëz, një ndër ta edhe Kryetarja e Grave të Sllovenisë. Kryetarja e Grave të Kroacisë, qikjo që m'ka thanë, "Ruani natalitetin edhe universitetin". E ka thirrë Lindën me shku në Zagreb, në Radio Televizionin e Zagrebit me punu. Për me u ballafaqu me jetë edhe mbeti.

Mandej, mbas luftës u punësu prapë në televizion se ka qenë kryeredaktore aty. Ka punu, ka dhanë kontribut shumë t'madh. Prapë s'u pajtu me politikën e televizionit që udhëheqke, keqpërdorimet edhe tha, "Unë asaj shoqnie nuk i takoj, asaj drejtorie nuk i takoj", edhe e la televizionin. Mandej është marrë, ka hapë ni butik, ka qepë fustana të nusnisë bashkë me shoqen e vet Xheraldinën. Mandej, familjarisht e çelëm ni kozmetikë, në rrugë te... në drejtim të Llapit te Vellusha edhe aty filloi e mbara.

Punojke djali, punojke Linda, mandej edhe nusja. Në mramje përgatitshim gjanat, në mëngjes i çojshim. E qashtu, me jetu. Por, ajo shitore, ajo kozmetika na dha të mbarën për mos me hekë.

Anita Susuri: Zonja Bahtije, kisha dashtë me juve me folë edhe për periudhën e luftës. Keni qenë ktu deri n'bombardime apo si ka qenë?

Bahtije Abrashi: Periudha e luftës ka qenë shumë e vështirë. U pa që do t'fillon lufta, pasojat kanë me qenë shumë t'mdhaja. Lindës ia ka vjedhë dikush kerrin edhe iu kanë kërcënu burrit t'vet, "Në qoftëse tregon që ta kena vjedhë kerrin do ta likfidojmë djalin", vetëm ni djalë. Kta tretë shkun në Maqedoni, Shkup. Unë, djali, nusja, nipi, i ndjeri mbetëm në Prishtinë. I ndjeri Azizi, shkoi, dul, kur erdhi tha, "I kom gjetë tri bileta. Kërkund s'mundemi me shku, as republikat tjera, as në Turqi, as në Mal të Zi, s'ka ma, krejt janë mbyllë. Po i kom gjetë biletat, autobusi i mramë për Sarajevë. Unë reagoja s'dojsha me shku, "Ma t'lutem, ma t'lutem!"

Djalin e kisha n'atë kohë në Londër me punë. Nusja veç kqyrke çka po vendosim. Ai prej toke në qiell m'lutke edhe më tha këte, "A e din qysh t'u kanë kërcënu në Fushë Kosovë, ai është programi i tyne. Të lutem përgatitu". Edhe shkova në Sarajevë, ai mbeti në shtëpi. Kështu që, katër vetë kena qenë n'katër anë të botës. Ai në Angli, i ndjeri mbet në Prishtinë, vajza në Maqedoni, une në Bosnje. Në Sarajevë kom ndejtë me nusen, me nipin ni muj, se e kisha ni vend ku me shku në Turqi, po s'kishte aeroport.

E prej Sarajevës kur kanë fillu me bombardu Serbinë edhe caqet në Kosovë, krejt Sarajeva ka qenë n'kamë. Dritat dhezë prej Avianos të Italisë shkojshin aeroplanat njëri pas tjetrit. Mandej mbas nja ni jave aeroplani i parë që ka fluturu për Turqi, kam kalu në Turqi me nusen. Atje na kanë, unë isha n'banesë, na kanë trajtu meniherë si refugjatë. E kur thojshin, "*Mültecî*" [Tur. refugjat] ishte fjalë e randë, o Zot, se ishe refugjat.

Nji numër t'madh të shqiptarëve i kanë vendosë në tenda, a une isha... kur n'mëngjes po vijnë dy burra n'derë, "Qito i keni prej Bashkësisë Lokale ndihma" edhe ishin shumë. Po në ni shtëpi tjetër e kisha ni kojshi të Mitrovicës, 25 vetë kanë qenë në ni banesë dy dhomëshe. Edhe gjysmën ia çova atyne, pak diçka nala për veti. Kështu që, axha Aziz mbet në Prishtinë. U friksojshim mjaft.

Anita Susuri: A keni pasë kontakt me to?

Bahtije Abrashi: Po kom pasë ni telefon n'hymje te kojshia, atyne s'ja u kishin ndërpre, nëpërmes e disha që është në Prishtinë. Por, ni kohë s'ka guxu me ndejtë n'banesë vet, ka shku me ni banesë tjetër me Burhanin edhe me ni shok të Burhanit. I kanë nxanë edhe i kanë rraf i kanë bo krejt zi shpinën edhe kanë dashtë m'i likfidu. Janë konsultu me dikë i kanë thanë, "Jo, se ata na duhen. Leni gjallë".

Anita Susuri: I ka rraf policia apo?

Bahtije Abrashi: Po, po. Policia. Djali im i kish pasë ndihmu ni oficeri me ia shpëtu djalin prej vdekjes me barna me... edhe ai ka qenë në ushtrinë e serbëve e ka thirrë djali jem, "M'ke thanë se kur jam ma s'ngushti unë do t'ndihmoj. Ti ki me shku me ma marrë babën prej banesës edhe me ma pru në

Shkup”, ai thotë, “U kry”. I ndjeri s’i ka besu. Thotë, “Jo, s’dal. Du me ndejtë në shtëpi”, edhe ai lajmëron, thotë, “S’po don me dalë, po don me ndejtë”.

Mandej, ai prapë e thirrë. Thotë, “Babë e kom shok, mos ki gajle n’besë mbështetju atij se”. Dikur e bind. Edhe kjo është shumë interesant. I thotë ai, “Ti ki me u bo shurdhmemec”. Mrapa i ka pasë dy paramilitarë të armatosun e ky oficeri po vozitë, ky i pari. Ai iu thotë atyne se e kam burrë të tezës. Po s’po din as me folë. Edhe qashtu si shurdhmemec e kanë qit’ atë anë të Maqedonisë. Kur e ka pa Gazmendi, Mena e thrrasim, që dul baba n’atë anë i ka ra të fikët.

Mandej, ka ndejtë në Maqedoni disa, ndoshta dy muj edhe erdhi në Turqi te unë edhe te nusja. Masi hyni NATO-ja u kthym. Unë u ktheva e para se m’kish vdekë vllau. Vllau i cili gjatë tanë luftës ka ndejtë në Mitrovicë, i ka pa krejt çka po ndodhë edhe unë fola me të në telefon. Hyni NATO-ja, tri ditë pa vdekë mandej e kthej turqisht për mos me u marrë vesh se u përgjojshin. Thotë, “Mos u friko kur t’vish në Mitrovicë është rrafsh me tokë”. Kiameti ma i madh kur kom kalu rreth tymtarit të Zveçanit, shkritorës i ka ardhë era gjithmonë mish. Kështu e kena mbaru bisedën.

Ai i ndjeri e ka thirrë ni kojshi, n’shtëpinë e ni shqiptarit kanë qenë paramilitartë, ushtria e krejt. Kur kanë dalë ka qenë shtëpia tre kat, e kanë lanë ujin lshutë. E ky kojshia serb si ka ni që është inxhinier i thotë, “Merri ato motorcanglat”, që çelin dyrtë a çka janë, “Hajde t’shkojmë t’ia çelim derën e Sylës se qishtu qishtu ia kanë lshu ujin”. Ky niset me shku. I thotë nana ime, “Mos shko, nanë!” Ka parandi diçka. “Po shkoj, po shkoj nanë se rahatohen tri familje”. Ka çelë derën, ky ka hi i pari e kanë ngulfatë helmet. Helmi i drogës, helmi i barutit. Ata krejt i kanë paramendu ato. E qiky serbi e ka ditë që ky din shumë gjana në Mitrovicë çka ka ndodhë, e ka organizu edhe është helmu, vdiq. E qishtu qe.

Anita Susuri: Kur jeni kthy mas luftës?

Bahtije Abrashi: Mas luftës kur jemi kthy kena ardhë në Prishtinë. Interesant Prishtinën s’e kishin shkatërru, e kanë lanë t’fundit. Jom ardhë n’banesë, vetëm banesën e kena gjetë, se aty ka qenë ni familje prej Mitrovice s’kanë shku... edhe kurgjo, kena pasë shitoret, kena pasë pasuri krejt rrafsh me tokë. Kerret, ni kerr kish mbetë n’garazhë, se djali krijoj kapital edhe fillum, fillun fmitë edhe vajza edhe djali me tregti me kozmetikë. Edhe kështu mbetëm në kambë. Dytë janë punëtorë t’mdhej. Azizi gjithmonë ka qenë i zhgënjymë. Ka pasë oferta me punu si ekonomist thojke, “Jo, pa u punësu minatortë, unë nuk punësohna”. Atij mandej ia ndërpre në penzionin edhe mu ma ndërpre në penzionin. Kena bo disa herë ankesa edhe në Republikën e Serbisë e krejt na kanë thanë, “Juve s’ju takon penzioni se jeni irridentista”. Por, dha Zoti, fëmitë u bonën të aftë edhe s’na kanë lanë me hekë hiç.

Anita Susuri: Zonja Bahtije, nëse keni edhe diçka që doni me shtu për fund ose keni harru me cekë?

Bahtije Abrashi: Faleminderit prej juve. Une gjatë kësaj jetës time kom edhe shumë çka me rrëfy, por ajo çka ke shumë interesant për juve e thashë. Faleminderit!

Anita Susuri: Faleminderit shumë për kohën.

Bahtije Abrashi: Të lutem, të lutem.